

VENDIM
Nr. 690, datë 9.10.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe zëvendësohet me:

“Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.”.

2. Lidhja nr. I “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës, institucione qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Lidhja nr. II “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet, rajonale dhe vendore”, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Në pikën 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Masat në përqindje të shkallëve të dëshmërisë për shëndetin e punonjësve, të përcaktuara në paragrafin e dytë, ndryshojnë, si më poshtë vijon:

i) Në shkallën e parë, në masën 1335 (një mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë në muaj;

ii) Në shkallën e dytë, në masën 4005 (katër mijë e pesë) lekë në muaj;

iii) Në shkallën e tretë, në masën 5340 (pesë mijë e treqind e dyzet) lekë në muaj;

iv) Në shkallën e katërt, në masën 6675 (gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

b) Paragrafi i tretë shfuqizohet.

c) Në shkronjën “ç” të paragrafit të parafundit, të pikës 9, fjalët “..., por jo më shumë se 60%, ...” zëvendësohen me ... “, por jo në shumë se 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

5. Pika 10 shfuqizohet.

6. Pika 12 shfuqizohet.

7. Në lidhjen I/1, “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjës të mbështetës në administratën e ministrive të linjës, institucioneve të pavarura e kushtetuese, institucione qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura, bëhen këto ndryshime:

a) Në numrin rendor 6, në klasën VIII, pas emërtesës: “Ndihmësspecialist” shtohen emërtesat:

- “Drejtues motobarke në Drejtorinë e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë”.

- “Drejtues skafi në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare.”.

b) Në numrin rendor 7, në klasën VII, pas emërtesës “Kontrollor anketimi”, shtohet emërtesa “Topograf”.

c) Në numrin rendor 8, në klasën VI, pas emërtesës “Magaznier” shtohet emërtesa “Punëtor motobarke në Drejtorinë e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë”.

8. Në lidhjen I/7, “Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjës të

mbështetës në sistemin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, në nënndarjen e dytë, pas fjalëve “...dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës...” shtohen fjalët “...dhe Cirkut Kombëtar...”.

9. Në numrin rendor 7, të lidhjes II/1, “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e institucioneve, rajonale dhe vendore, si dhe të institucioneve qendrore, të grupit të tretë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes”, në klasën IX, pas emërtesës “Motopompist” shtohet emërtesa “Topograf”.

10. Në lidhjen III, shkronja “gj” e pikës 1, shfuqizohet.

II. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, për vitin 2012, do të përballohen:

- Për efekt të rritjes së pagave për çdo klasë, nga fondi i politikave të pagave, të parashikuara për vitin 2012;

- Për parashikimet e tjera, nga fondet e miratuara tashmë për secilin institucion për vitin 2012.

III. Efektet financiare:

- Për Drejtorinë e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë, dhe Cirkun Kombëtar, fillojnë nga momenti i emërimit të punonjësve në detyrë. Për këta punonjës vlera e pagës për klasën përkatëse nga momenti i emërimit në detyrë deri në datën 15 korrik 2012, do të jetë ajo e përcaktuar sipas vendimit nr. 551, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave;

- Për parashikimet e tjera, nga data 15 korrik 2012.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha